

KONTRATË DHURIMI

i kuotave të ortakut Alfredo Colangelo në favor të
Mohamed Dosukey Mohamed Ibrahim Aman

Sot në Tiranë, më 20.12.2021, lidhet kjo kontratë dhurimi midis palëve të mëposhtme:

Dhuruesi: *Z. Alfredo Colangelo* zotërues i 50% të kuotave të FYDA shpk, me NUIS M12317004F dhe adresë Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Andon Zako Çajupi, Ndertesa 2, Hyrja 13, Ap.8, kodi postar. 1019 (në vijim Dhuruesi).

Dhe

Përfituesi: *Z. Mohamed Dosukey Mohamed Ibrahim Aman*, zotërues i 50% të kuotave të FYDA shpk, me NUIS M12317004F dhe adresë Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Andon Zako Çajupi, Ndertesa 2, Hyrja 13, Ap.8, kodi postar. 1019, (në vijim Përfituesi).

Palët në marrëveshje midis tyre, me vullnetin e tyre të lirë si dhe në përputhje me nenet 761 e në vijim të Kodit Civil, ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe Statutin e Fyda shpk bien dakord për lidhjen e kësaj kontrate si më poshtë vijon:

NENI 1

Objekti i kontratës

1. Objekti i kësaj kontrate është dhurimi i 50% (pesëdhjetë përqind) të vlerës së kapitalit, të shoqërisë Fyda shpk me Nuis: M12317004F, që zotëron pala dhuruese në favor të palës përfituese.

NENI 2


Qëllimi

Kjo kontratë ka për qëllim kalimin pa shpërbllim të pronësisë së 50% (pesëdhjetë përqind) të kuotave të kapitalit të subjektit Fyda shpk sipas objektit të kësaj kontrate, tek Përfituesi.

NENI 3

Deklarimet e palëve

1. Pala dhuruese deklaron se:
 - a. është pronare e 50% (pesëdhjetë përqind) të kuotave të shoqërisë Fyda shpk;
 - b. garanton palën përfituese se këto kuota janë të lira nga çdo barrësim dhe detyrim karshi të tretëve dhe për çdo pretendim që mund të ngrenë të tretët për cënimin e pronësisë së palës pranuese të dhurimit, unë jam i gatshëm dhe i detyruar të paraqitem menjëherë me kërkesën e palës pranuese të dhurimit dhe të çdo personi tjetër të tretë, që pretendon mbi këto kuota, para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për të mbrojtur të drejtën e saj, si pronar i ligjshëm i këtyre kuotave pas nënshkrimit të kësaj kontrate.
2. Pala përfituese deklaron se e pranon dhurimin e 50% (pesëdhjetë përqind) të vlerës së kapitalit, të shoqërisë Fyda shpk me Nuis: M12317004F, që zotëron pala dhuruese.
3. Palët bashkarisht deklarojnë se:



Mohamed Dosukey faqe 1 nga 3

- a. të gjitha detyrimet e përshkruara më lart dhe të gjitha ato që burojnë nga kjo kontratë dhurimi janë realizuar prej tyre dhe ato nuk kanë asnjë detyrim të ndërsjelltë midis tyre dhe nuk do të ketë asnjë detyrim në të ardhmen;
- b. Kuotat janë marrë në dorëzim nga pala pranuese e dhurimit në gjendjen që janë dhe ato nuk kanë asnjë pretendim lidhur me këtë veprim.

NENI 4

Efektet e kontrates

1. Kalimi i pronësisë së kuotave nga pala dhuruese tek pala pranuese në përputhje me përcaktimet e kësaj kontrate përfundon me regjistrimin e kësaj kontrate pranë QKB në përputhje me legjislacionin në fuqi për qendrën kombëtare të regjistrimit.

2. Kalimi i pronësisë së kuotave sipas kësaj kontrate regjistrohet në përputhje me ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, i ndryshuar.

NENI 5

Pranimi i përfituesit

Përfituesi i kuotave, objekt i kësaj kontrate, pranon dhurimin pa pasur asnjë vërejtje me nënshkrimin e kësaj kontrate.

NENI 6

Dokumentacioni i dhurimit

Kësaj kontrate dhurimi i bashkëlidhen, dokumentacioni përkatës si vijon:

- a. Vendimi i Asamblesë së ortakëve nr.2, datë 20.12.2021 i shoqërisë FYDA shpk;
- b. Dokumentet identifikues të palëve.

NENI 7

Forca madhore

1. Dhuruesi nuk do të jetë përgjegjës dhe/ose ka të drejtë të zgjidhë kontratën në rastet e forcës madhore, të cilat përfshijnë, por pa u kufizuar në to, katastrofat natyrore, luftërat, kryengritjet dhe/ose çdo shkak tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të Dhuruesit, që nuk përmbush detyrimet e tij për këtë arsye.


NENI 8

Dispozita të fundit

1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate nga palët, dhuruesi heq dorë nga pronësia e 50% (pesëdhjetë përqind) të kuotave të shoqërisë FYDA shpk në favor të përfituesit i cili fiton pronësinë e 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të FYDA shpk duke u bërë oraku i vetëm i kësaj shoqërie me 100% të kuotave.

2. Perveçse kur parashikohet ndryshe në këtë kontratë, çdo palë do të përballojë shpenzimet e veta në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate.

3. Kjo kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.




4. Mosmarrëveshjet, që mund të lindin ndërmjet palëve, do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që burojnë nga zbatimi i kësaj kontrate është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Kjo kontratë përmban 3 (tre) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipe, në 2 (dy) kopje origjinale me të njejtën vlerë ligjore.


6. Palët autorizojnë znj. Brisilda Sakiqi me numër personal J76206040A për të paraqitur dokumentacionin përkatës dhe kryer veprimet e nevojshme për regjistrimin e ndryshimit në Qendrën e Regjistrimit të Biznesit, brenda 30 ditëve.

Dhuresi



Z. Alfredo Colangelo

Përfituesi



Z. Mohamed Dosukey Mohamed Ibrahim Aman

